



Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria për Forcën e Sigurisë
NJOFTIM PËR KONTRATË
FURNIZIM

Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 15.09.2016

Nr i Prokurimit	21700	16	036	121
------------------------	--------------	-----------	------------	------------

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip

Serbisht

Anglisht

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: Ministria për Forcën e Sigurisë		
Adresa Postare: Objekti i Ministrisë, numri i zyrës 139, Kazerma "Adem JASHARI" 'rr. Magjistrale Prishtinë-Mitrovice,		
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10 000	Vendi: RKS
Personi kontaktues: Afrim MAXHUNI		Telefoni: 038/200 13 500
Email: afrim.maxhuni@rks-gov.net		Faksi: 038/200 13 501 ose 2
Adresa e Internetit (nëse aplikohet):		http://www.mksf-ks.org/

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po

Jo

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Po

Jo

Nëse po, specifiko identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi.

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: RI TENDER Furnizimi me pajisje të sistemit informative gjeografik- GIS për nevojat e FSK-se		
II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit (Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime - e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)		
<input type="checkbox"/> Punë	<input checked="" type="checkbox"/> Furnizime	<input type="checkbox"/> Shërbime
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input checked="" type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	
Vendi apo vendndodhja	Vendi kryesor i dorëzimit	Vendi kryesor i

kryesore e punëve	Kazerma "Adem JASHARI" Prishtinë	realizimit
II.1.3) Njoftimi përfshinë		
Krijimin e kontratës publike kornizë Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):		
Kontrate publike kornizë me një operator	<input type="checkbox"/>	
Kontrate publike kornizë me disa operator	<input type="checkbox"/>	
Ekzekutimi i kontratës:		
Thirrje/Porosi	<input type="checkbox"/>	
Kontrata ndihmëse/Mini-konkurrencë	<input type="checkbox"/>	
Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë:		
II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës		
Përshkrimi i shkurtër dhe analiza e problemit		
<p>Forca e Sigurisë së Kosovës ka një kohë të gjatë që ka nevojë për krijimin dhe digjitalizimin e hartave të ndryshme që posedon në kuadër të vetin. Të gjitha hartat egzistuese janë të pa digjitalizuara dhe është mëse e nevojshme që këto të përshtaten dhe adaptohen për një form të re digjitale.</p> <p>Gjithëashtu në kuadër të FSK nuk ekziston një ekip i caktuar i cili mund të merrej me përpunimin e shënimeve të gjeoinformacionit dhe si të tilla t'i bëjë të disponueshme dhe të shfrytëzueshme për të gjithë pjestarët e FSK. Në kuadër të institucionit nuk disponojmë me personel i cili ka njohuri të mjaftueshme mbi gjeoinformacionin si dhe nuk kemi pasur trajnime të caktuara për aplikacionet GIS profesionale apo aplikacionet tjera të nevojshme për përpunimin e të dhënave të hartave.</p>		
Objektivat e projektpropozimit:		
<p>Objektivat primare të këtij projekti janë ngritja e kabinetit për GIS në kuadër të FSK-së si dhe aftësimi i pjestarëve të saj mbi gjeoinformacionin dhe aplikacionet që shfrytëzojnë për krijimin e gjeoinformacionit. Gjithashtu personeli do të ketë mundësinë për tu aftësuar për përdorimin e pajisjeve të ndryshme GPS të cilat kanë një saktësi mjaft të madhe inxhinjere.</p> <p>Qëllimi i projektit është të krijon një personel profesional që do të ndihmojë në PVMU në mënyrë substanciale ndërtimin e GIS të FSK -së dhe aftësimin e mëtutjeshëm të pjesëtarëve tjerë të FSK-së.</p> <p>Me anë të këtij kabineti dhe pjesëtarëve të trajnuar do të krijohen parakushtet që institucioni i FSK-së të ndërtoj dhe mirëmbaj një sistem të përshtatshëm të GIS-it i cili të ndihmojë në realizimin më të lehtë të misionit të vetë dhe objektivave të FSK-së.</p>		
Rezultatet që duhet të realizohen		
<p>Reth 10 pjesëtarë të FSK do të përzgjidhen për trajnimin. Procedurat për zgjedhjen e tyre do të përcaktohen në atë formë që personat e zgjedhur të jenë të aftë të përvetsojnë njohurit kryesore mbi GIS si dhe krijimin e digjitalizimin e hartave.</p> <p>Ata duhet të kenë një paranojë të mjaftueshme për përdorimin e kompjuterit dhe softëwareve tjera si Windows, Microsoft Office si dhe njohuri gjenerale mbi hartat.</p>		

Kabineti i ndërtuar me server dhe me 10 kompjuter, GPS-sa si dhe software profesional perkatese per GIS të cilët do të lehtësojnë përvetsimin e njohurive dhe realizimin e detyrave të pjesëtarëve të trajnuar mbi gjeoinformacionin dhe pajisjet e nevojshme për krijim të gjeoninformacionit.

Impaktet dhe rezultatet kryesore që do të realizohen me këtë projekt do të jenë si vijojnë më poshtë:

- Krijimi i kabinet të GIS në kuadër të KDS-FSK
- Blerja e pajisjeve teknike në kuadër të kabinetit si kompjuter, ploter etj.
- Përfitim i GPS per matje të sakta dhe precize
- Përfimi i softwarë-ve profesional për krijimin dhe digjitalizimin e hartave, si dhe përpunimin e gjeoinformacioneve
- Trajnimi i suksesshëm i pjesëtarëve të FSK-së

Përfitimi nga ky projekt

Projekti do të ketë një impakt direkt dhe indirekt në kuadër të FSK-së

Përfitues Direkt:

- Pjesëtarët e FSK-së do të përfitojnë trajnim për GIS dhe digjitalizim të hartave.
- FSK do të përfitoj një kabinet dhe pajisje GPS me precizitet të avancuar

Përfitues indirekt:

- Të gjithë pjesëtarët e FSK do të përfitojnë nga stafi i trajnuar të cilët në të ardhmen do ti përpunojnë të gjitha geoinformatat e nevojshme për FSK-në.

Kohëzgjatja e projektit

Implementimi i projektit duhet te zgjasë rreth tre muaj.

Muajin e parë do të bëhet implementimi i pjesës së kabinetit të GIS-it (instalimi i kompjuterëve, serverit, dhe pajisjeve tjera).

Pas instalimit të pajisjeve do të fillon procesi i trajnimit të pjesëtarëve të përzgjedhur për trajnim. Ne fazën e fundit do të bëhet një monitorim i pajisjeve të instaluara dhe evaluimi i trajnimit.

Detyrat kryesore për realizimin e projektit:

Detyra 1: Përgaditja e dokumentacionit për realizimin e projektit.

Detyra 2: Përzgjedhja e kompanisë për realizimin e Kabinetit të GIS-it dhe trajnimeve.

Detyra 3: Parapërgaditja e pajisjeve të zyrës ne kabinetin e GIS-it siq janë tavolinat, karrigat dhe inventarit tjetër për instalimin e pajisjeve tjera elektronike.

Instalimi i pajisjeve kompjuterike në kabinetin e GIS si:

- Serverit
- Kompjuterëve
- Software profesional per GIS
- Plotterit
- GPS

Detyra 4: Instalimi i softëwareve të nevojshëm në kompjuter dhe server, si dhe aplikacioneve tjera për realizimin e trajnimeve. Pasi te bëhet instalimi njëherësh bëhet edhe kontrollimi i funksionimit të sistemit.

Detyra 5: Përzgjedhja e kandidatëve për trajnim

Detyra 6: Trajnimi për desktop software profesional të GIS-it për harta.

Ne kete trajnim parashihet qe kandidati-et(mesimnxenesi-it) te mesojne njohurit themelore me veglat e software siq jane: veglat per vizatim te vijave pikave dhe siperfaqeve; te merr nohuri themelore per:

- a. Leximin e fajllave te jashtem te inkorporueshem per software siq jane formati "shapefile" apo te njohur si .shp ekstension si dhe .mif ekstension file, po ashtu edhe te ngjashme si: .dgn, .dxf, .xls etj.
- b. Te merr njohuri mbi databazat e .shp fajllit domethenia se si duhet perkatitur forma tabelare e databazes .shp fajllit dhe kodimi apo pershkrimi per atributet(veqorite) e databazes se shapefile,
- c. Te mesoj se si punohet me raster images(raster harta fotografive) dhe qe kandidati duhet te mësohet të beje gjeoreferencimin e ketyre sipas sistemit koordinativ te projeksionit paraprak te softwareit,
- d. Te mesoj hapat e definimit te interkonecioneve te gjeometrive pra te dije se cka eshte gabimi "overlapping" i gjeometrive si "vije mbi vije gjeometri" apo "poligon mbi poligon gjeometri" apo edhe kryqezimet e gjeometrive si "vija gjeometri ne kryqezime" dhe te ngjajshme,
- e. Te mesoj mbi pregatitjen e te dhenave per vizualizim(toolsat e softwareit per vizualizim) pra paraqitja 2dimensionale e te dhenave te perpunuara dhe te mesoj interpretimin e te dhenave ne vizualizim,
- f. te mesoj pergatitjen apo ruajtjen e te dhenave te formatit per .mif apo .shp file te softwareit dhe te dije te beje eksportimin e te dhenave po ne keto formate perkrahese te softwareit.
- g. Trajnuesi profesional duhet te jape edhe ndihme ne sugjerime sipas kerkeses gjat trajnimit apo pyetjeve eventuale te kandidateve ne lidhje me domenen e ketij trajnimi apo edhe sugjerime te ngjajshme per fushen e GIS.
- h. Kandidati te merr apo mesoj njohuri te pergjithshme per relacionin se si te dhenat jane te ndrlidhura apo software krijon interkoneksione te jashtme me databazat e jashtme apo databaza qe nderlidhen me te dhenat qe do te krijohen gjeometrite ne software: siq jane leximi i formatit per sistemin koordinativ te projeksionit, lidhshmeria e te dhenave me relacionin e e databazave te jashtme si shapefile databaza etj, dhe te ngjajshme gjenerale.

Vërejtje: Minimumi i oreve mësimore që duhet të realizohen është 40 orë shkollore.

Detyra 7: Trajnimi për software -server për GIS Server.

Puna me GeoWorkspaces:

GeoWorkspace është dokument qendror ku mund të shikohen të dhënat nga burimet e ndryshme si të dhëna grafike në dritaren e hartës apo si të dhëna të klasifikuara në dritaren e të dhënave. Dokumentet e GeoWorkspace-it kanë ekstensionin (formatin) .gws dhe janë të deponuara në direktoriumin e paplotësuar C:\GeoWorkspaces që është krijuar kur është instaluar softueri. GeoWorkspace-i në fakt nuk i deponon të dhënat – e deponon vendin e burimit të të dhënave pasi që janë emruar lidhjet e rrugës. Si që u përmend GeoWorkspace mund të jetë si kamerë shikimi për të dhënat, ku mund të qëndrojnë lokalisht apo në rrjetë. Si shtesë e deponimit të emrave të lidhjeve të të dhënave, GeoWorkspace deponon se si duken të dhënat si dhe shfrytëzuesi definon pyetjet e tij, në formë të pyetjetve për hartimin e hartve tematike dhe attributeve të bazës së të dhënave.

Puna me Sistemin Koordinativ:

MGE, Access, Oracle, ARC/INFO, MapInfo, dhe formatet tjera të këtij lloji janë depo që prezantojnë burimet e të dhënave që mund të shikohen në GIS Software Server Profesional Professional. Gjithashtu edhe të dhënat në sejcilën depo mund të deponohen në projeksione të ndryshme hartografike, GIS Software Server Profesional për shikim mund të transformojë të dhënat në projekt të vetëm të GeoWorkspace-it. Projeksioni i GeoWorkspace-it mund të ndryshohet në çfarodo kohe që ti shikosh të dhënat nga depot e ndryshme në projeksion të ri. Ky transformim i projeksionit në mes të deposë së burimit të të dhënave dhe të GeoWorspace është e bërë automatikisht për të gjitha elementet momentalisht të shikuara në GeoWorkspace. Të dhënat të ruajtura në depo mund të deponohen (ruhen) në njërën nga dy formatet e mëdha:

Geographic (Gjeografike) apo Projected (të projektuara). Geographic deponon të dhënat në kënde të matura më parë në shkallë, minuta dhe sekonda. Projected deponon të dhënat në formatin X,Y referuar asaj Easting, Northing. Të dhënat shikohen dhe transformohen nga depotë përgjatë emrave të lidhjes së definuar të shfrytëzuesit. Këto lidhje të emruara janë themeluar duke përdorur programe të GIS Software Server Profesional të ashtuquajtura servera për të dhënat (data servers), që janë të dizajnuara në mënyrë specifike për interes të depove. Për shembull, Serveri i të Dhënave MGE është program i GIS Software Server Profesional e dizajnuar për tu lidhur me depon MGE.

Lidhja me Deponë e Access-it:

Bazat e të dhënave të Access-it, Oracle-es, dhe Serverit SQL mund të shërbejë si depo read-only apo read/write për GIS Software Server Profesional ku si atributet poashtu edhe grafikat mund të deponohen (ruhen), ndryshohen dhe shlyhen. Lidhja e njëres nga këto depo mund të vendoset si read/write (lexo/shkruaj) apo si read-only (vetëm e lexueshme) kur krijohet lidhja. GIS Software Server Profesional mund të ketë lidhje me shumë depo.

Lidhja me depon ArcView dhe ARC/INFO:

GIS Software Server Profesional mund të krijoj lidhje vetëm –për tu lexuar me ArcView dhe ARC/INFO depon e të dhënave të deponuara . GIS Software Server Profesional serveri i të dhënave kërkon informata lidhur me projektimin e hartave të depove të ArcView and ARC/INFO kështu që të dhënat prej këtyre depove shfaqen në lokacione gjeografike të sakëta.

Përdorimi i filtereve hapsinor:

Shikimi i të dhënave GIS Software Server Profesional Workspacemund të kufizohet në hapsirë të veçantë gjeografike nëpërmes përdorimit të filtrimit hapsinor. Filtrimi hapsinor mund të zvogloj sasinë e të dhënave të shfaqura dhe të përpunuara. Filtert hapsinorë mund të emërohen dhe deponohen në GeoWorkspace.

Legjendat kontrolluese dhe dritarja e hartës:

Gjëja më e rëndësishme për kontrollimin e përmbajtjes së dritares së hartës është të kuptuarit e përdorimit të hartës së legjendës. Legjenda mund të përdoret për stilizim të (ngjyrës, stilit të vijave, mbrehtësisë së vijave, mbushjes së ngjyrës, tekstit dhe theksimit të madhësisë së simboleve, e kështu më tutje) të artikujve të paraqitur në dritaren e hartës.

Cilësitë e emrave të klasës mund të radhiten në legjendë dhe mund të ri-emërohen me emra të ndryshëm.

Përdorimi i të dhënave të dritares:

Kur t'i shohim informatat grafike në dritaren e hartës, secila veçori grafike prezenton një regjistër në tabelën e të dhënave. Të dhënat e dritares paraqesin një mundësi për t'i parë të gjitha regjistrat e zgjedhura në klasën e veçorive apo në tabelën jo-grafike. Të dhënat e dritares për tabelat grafike përmbushin ndonjë fiter hapësinor të cilët mund të përdoren.

Definimi i klasës së veçorive:

Definimi i tabelës së bazës së të dhënave përbëhet nga emri i tabelës, attributeve të emrave të kolonës, dhe tipeve të të dhënave të kolovane. Në GIS Software Server Profesional Professional, tabela mund të jetë grafike apo jografike. Për tabelat e klasës së veçorive grafike, definimi i tabelave është e zgjeruar që të përfshijë tipet gjeometrike (pikat, linjat, sipërfaqet, tekstin apo veçoritë e përbëra).

Synimet e këtij mësimi janë që të demonstrojë se si duhet të:

Krijimi i Lidhjeve (Joins):

Të dhënat e lidhura shpeshherë janë të ruajtura në tabela të ndryshme. Nëse tabelat kanë atributet e kolonave që janë në lidhje dhe janë të një tipi të njëjtë i të dhënave, mund të krijohet lidhja mes dy tabelave dhe të ruhet si lidhje (join). Lidhja mundëson që të shikohen dy tabela si një tabelë, duke mundësuar lidhjen e veçorive grafike në tabelën e të dhënave jografike.

Hartografia Tematike:

Hartografia tematike është proces i vendosjeve të shpejta dhe të lehta të stileve të veçorive (ngjyrat, madhsia e pikave, etj.) bazuara në vlerat e attributeve të klasës së selektuar të veçorive. Për shembull, klasa e veçorisë e quajtur (si në *USSampleData.mdb*) mund të hartografohet tematikisht ashtu që shtetet janë të mbushura me ngjyrë bazuar në vlerat mesatare të temperaturës

Deponimi me GIS Software Server Profesional:

GIS Software Server Profesional mund të lexojë dhe të shkruaj të dhënat në bazën e të

dhënave të Access-it, Oracle-s, dhe SQL Server. Sejcila nga këto baza të të dhënave mund të krijohet në mënyrë të jashtme në GIS Software Server Profesional Professional.

Gjeokodimi i Koordinatave:

Komanda GeoCode Coordinates mund të përdoret për të vendosur pika bazuar në atributete e vlerave gjeografike apo të projektuara. Komanda mundëson instalimin që nevojitet për të definuar tabelën, projektionin, dhe njësinë ruajtëse të çiftit burimor koordinativ.

Vendosja e Zonave Buffer:

Zona Buffer është regjion i definuar nga shfrytëzuesi përreth apo përbrenda një apo më shumë veçorive, për shembull, zonë buffer një milje përreth Stacioneve të Zjarrfikësve.

Puna me Queries (Pyetje):

Queries janë pyetje të parashtruara në bazën e të dhënave. Attribute queries dhe spatial queries (pyetjet hapsinore) janë dy tipe themelore të pyetjeve (queries) që përdor GIS Software Server Profesional Professional. Attribute queries bën pyetje që mund të përgjigjen nga informatat e atributeteve të ruajtura në tabelë të deposë;

Futja e Veçorive:

Futja e veçorive në GIS Software Server Profesional është proces i krijimit të (vizatimit) të punës së re grafike. Shembujt e këtyre grafikeve janë të ruajtura si inçizime të reja (rreshta) në deponë e tabelave read-write të klasës së veçorive të Access, Oracle, apo SQL Server. Tipet e grafikave (linjave, sipërfaqeve, pikave, tekstit) që mund të krijohen përcaktohen nga tipi i gjeometrisë i definuar për tabelën e klasës së veçorive.

Insertimi i veçorive të sipërfaqeve nga opcioni sipas "Face":

Duke përdorur komandën Insert Area by Face, mund të futen veçori të reja të sipërfaqeve në modulën interaktiv apo të gumbulluar duke përdorur sipërfaqet e definuara nga veçoritë tjera të selektuara. Veçoritë e selektuara mund të jenë lineare dhe/ose sipërfaqe gjeometrike.

Azhurimi i Atributeteve:

GIS Software Server Profesional ka dy komanda të fuqishme të disejnuara për azhurimin e atributeteve të veçorive, Update Attributes dhe Update Attributes Using Text.

Bërja e Pyetjeve të shtresuara hapsinore:

Komandat Spatial Intersection dhe Spatial Difference mund të përdoren për të bërë analiza të shtresave të veçorive dhe pyetjeve. Spatial intersection kthen sipërfaqen e ndërprerjeve brenda dy veçorive apo pyetjeve. Ndërprerja procesohet me operatorë hapsinorë, të cilat definojnë ndërprerjen e sipërfaqes..

Futja (Insertimi) i Imazheve:

GIS Software Server Profesional jo vetëm që bën selektimin e zgjedhjeve për gjendje anësore bazuar në kriteriumet e kërkuara, por mund të përdoret gjithashtu për të shikura imazhe të ndryshme raster. Shikimi i hartave të skenuara (vizatimi, aerofotot dhe imazhet tjera) mund të ju kursejë kohë gjatë punës në terren.

Organizimi i digjitalizimit:

Organizimi i digjitalizimit është proces i përdorimit të imazhit raster për të vendosur grafike të reja vektoriale në deponë e GeoWorkspace-it read/write. Së pari imazhi duhet të jetë gjeografikisht korrekt në pozitën e sajë në GeoWorkspace. GIS Software Server Profesional ka mjete për regjistrimin e imazhit në mënyrë manuale atëherë kur imazhi nuk është i ruajtur tashmë në pozicionin korrekt gjeografik.

Analizimi i Gjeometrisë:

Komanda Analyze Geometry mund të përdoret për të llogaritur sipërfaqe, perimetër, dhe sipërfaqe/perimetër të veçorive të sipërfaqeve dhe pyetjeve. Mund të përdoret gjithashtu për të llogaritur gjatësinë e veçorive lineare dhe queries (pyetjeve).

Insertimi (futja) e Tekstit dhe labelsave:

Në GIS Software Server Profesional Professional, gjenden dy tipe të shënimeve të tekstit që dallohen në bazë se si është krijuar teksti. Vendosja e tekstit duke përdorur komandën Insert Text bëhet nga shfrytëzuesi dhe është e ruajtur në klastabelën e saj të veçorive.

Puna me Veçoritë:

Atributet e veçorive të ruajtura në deponë read/write të Access-it, SQL Server-it, dhe Oracle lehtë mund të të shikohen dhe ndryshohen si nga dritarja e hartës ahtu edhe nga dritarja e të dhënave.

Miratimi i të dhënave dhe korrektimi gjeometrik:

GIS Software Server Profesional ka mjete që ju mundëson që të mbani të dhëna në tërësi duke

miraturat gjeometrinë dhe lidhjen. Si shtesë, produkti mundëson mjete për të korrigjuar të dhëna duke bërë koordinimin dhe shtrirjen e gjeometrisë në ndërprerje, futje të ndërprerjeve, korrigjimin e lidhjes, dhe korrigjimin e gjeometrisë.

Eksportimi i të Dhënave:

GIS Software Server Profesional mund të eksportojë veçori të ndryshme në formate të ndryshme. Formatet përfshijnë: fajllin e disejnuar MicroStation, fajllmodelin e ArcView, MapInfo Interchange, MS SQL Server, dhe Oracle Object Model. Kur eksportojmë në Serverin e MS SQL apo Oracle Object Model, komanda për eksportim gjeneron fajllat e të dhënave të nevojshme ASCII që të përdoren me çdo mjet përkatës të ngarkuar të bazës së të dhënave.

Pllotimi:

Grafikat në dritare të hartës mund të shtypen/plotohen duke përdorur dritaren për ekspozim të GeoWorkspace-it. Kjo dritare u mundëson të dhënave të një apo më shumë dritareve të hartës që të futen dhe të ekspozohen për shkaqe plotimi.

Futet dritarja e hartës së GIS Software Server Profesional dhe informatat e legjendës në dritaren për ekspozim.

Ndërtimi i Dritares së Hartës dhe Legjendës për Plotim:

Metoda më e lehtë për të plotuar të dhëna është që së pari të ndërtohet dritarja e hartës dhe legjenda e hartës që të duket ashtu si kemi dëshirë për plotim.

Vërejtje: Minimumi i oreve mësimore që duhet të realizohen është 40 orë shkollore.

Detyra 8: Trajnimi për GPS

Përdorimi i GPS-se për futjen në punë për marrjen apo incizimin e koordinatave në terren. Procedurat e azhurnimit të të dhënave gjat incizimit të koordinatave në terren.

Zbrazja e shënimeve nga paisja GPS për në PC.

Konvertimi i të dhënave nga standardi i formatit të GPS (formati i GPS) paisjes për standard të PC si: .xls apo .txt fajll i të dhënave.

Vërejtje: Minimumi i oreve mësimore që duhet të realizohen është 10 orë shkollore.

Evaluimi i pajisjeve dhe trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit të stafit të përzgjedhur duhet të bëhet një evaluimi i gjithë procesit të implementimit të kabinetit të GIS si dhe trajnimeve të realizuara.

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 30

II.1.7) Variantet pranohen

Po Jo

II.1.9) Ne rast të një apo më shumë pjesëve (nëse aplikohet): NA

II.1.10) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen): NA

II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës: 58,000.00 €

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm

Nr.	Emri	Sasia
1	Server	1 copë
2	Desktop kompjuterat	10 copë
3	Monitor Brand Name i njejte sikurse Desktopi	10 copë
4	Plotter 44"	1 copë
6	GPS Profesional	1 copë
7	GIS – Desktop Software for mapping	5 copë
8	GIS – Software Server	1 sistem

Po ashtu operatori ekonomik duhet të bëjë trajnimin sipas programeve

1. Trajnim për GIS –Desktop Software for mapping 15 persona

2. Trajnim për Server/softuer Aplikacionin e GIS 15 persona
3. Trajnim për GPS 15 persona

Operatorët Ekonomik duhet të ofrojnë metodologjinë- zgjidhjen që duhet të përfshijë produktet sipas specifikimit teknik të përshkruar në vijim ose zgjedhje ekuivalente ku si minimum duhet të plotësohen të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale. Zgjedhja e ofruar duhet të plotësojë këto kërkesa, duke përfshirë; produktet, sasinë, dhe garancionin e prodhuesit.

Operatori Ekonomik duhet të ofroj softuer të licencuar (nuk lejohen GIS softuera free open source apo të modifikuar)

Operatori Ekonomik do të bëjë implementimin e projekti sipas kërkesave në specifikimin teknik në dosjen e tenderit

Të gjitha pajisjet duhet të kenë garancinë 24 muaj dhe Operatori Ekonomik është i obliguar që të bëjë mirëmbajtjen e sistemit gjatë fati garantues 2 vjeçare

Operatorët Ekonomik duhet të ofrojnë metodologjinë- zgjidhjen që duhet të përfshijë produktet sipas specifikimit teknik të përshkruar në vijim ose zgjedhje ekuivalente ku si minimum duhet të plotësohen të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale. Zgjedhja e ofruar duhet të plotësojë këto kërkesa, duke përfshirë; produktet, sasinë, dhe garancionin e prodhuesit.

Operatori Ekonomik duhet të ofroj softuer të licencuar (nuk lejohen GIS softuera free open source apo të modifikuar)

Operatori Ekonomik do të bëjë implementimin e projekti sipas kërkesave në specifikimin teknik në dosjen e tenderit

Operatori Ekonomik duhet të ofroj të gjitha produktet ISO standarde

Nëse për shkak të mungesës së njohurive tona në këto sisteme, mund të ketë mangësi në pajisje ose specifika të këtyre pajisjeve, Operatori Ekonomik duhet të analizojë dhe zgjedhjen e ofruar (harduer dhe softuer) duhet të bëjë funksionale këtë sistem.

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo

Fillimi Me nënshkrimin e kontratës

Përfundimi jo më vonë 15.12.2016 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës (nga momenti i marrjes së urdhër blerjes)

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po Jo

Nëse po, vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës me kohëzgjatje +30 ditë

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet

kontrata (nëse aplikohet):

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës Po Jo

Nëse po, përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1: Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin

Kërkesa 2: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.

Kërkesa 3: Një formular ekstrakt nga “regjistri gjyqësor” apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Deklaratë nën betim –duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe i vulosur nga O. Ekonomik

Evidenca 2: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore – duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës– origjinal

Evidenca 3: Vërtetimin nga Gjykata themelore – duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës– origjinal

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 4. Certifikata e regjistrimit të biznesit

Kërkesa 5. Certifikata e regjistrimit të TVSH-së

Kërkesa 6. Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 4. Kopja e Certifikatës se regjistrimit të biznesit

Evidenca 5. Kopja e Certifikatës e TVSH-së

Evidenca 6. Kopja e Certifikatës me numër fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Kërkesa 7. Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë të hyrat e përgjithshme se bashku për tri vitet e fundit (2013,2014,2015) minimum në vlerë prej 100,000.00 €,

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 7. Raportin ose raportet përkatëse nga një ose më shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar – duhet të dorëzohet në origjinal

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Kërkesa 8: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses furnizimin dhe instalimin e pajisjeve të njëjta ose të ngjashme pjesë të këtij tenderi gjatë tre (3) vitet e fundit (2013, 2014, 2015) minimum në vlerë prej 75,000.00 €,

Kërkesa 9: Në rast se tenderuesi nuk është prodhues i pajisjeve të kërkuar, tenderuesi duhet të dorëzojë Formularin e Autorizimit nga Prodhuesi ose dilleri për shitjen e këtyre produkteve pjesë të këtij tenderi; për secilën pajisje dhe softuer, të cilën oferton.

Kërkesa 10: Operatori ekonomik duhet të ofrojë katalogu nga prodhuesi me fotografi dhe specifikim teknik detal për secilin produkt të kërkuar.

Kërkesa 11: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi Listën e të punësuarve – Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve pjesë e këtij tenderi: Menaxherit të projektit, i cili duhet të jetë inxhinierë i teknologjisë Informative me përvojë minimumi 3 vjet; Minimum duhet të prezantojë tre punëtorë të kualifikuar për instalime, konfigurime dhe trajnime

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 8: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë listën e kontratave të nënshkruar dhe realizuara gjatë tri viteve të fundit 2013, 2014, dhe 2015, në origjinal, të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, të dëshmuar me referenca në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritetet për përkatës, për furnizimet e realizuar dhe pranuar, minimum në vlerë prej 75,000.00 €, të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e shërbimit dhe vendin e realizimit të furnizimeve

a. Kur furnizimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (në referenca të jete e cekur vlera e furnizimeve) të lëshuara nga autoriteti i tillë.

b. Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, duhet të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (në referenca të jete e cekur vlera e furnizimeve) të lëshuara nga blerësi i tillë.

Asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca për kryerjen e furnizimeve ose raportet e pranimeve teknike të furnizimeve.

Evidenca 9: Autorizimi nga prodhuesi apo dilleri për shitje me emër të projektit, numër të prokurimit – origjinal ose kopje e noterizuar nga origjinali

Evidenca 10: Operatori ekonomik duhet të ofrohet katalogu nga prodhuesi me fotografi dhe specifikimit detal për secilin produktet të kërkuar. duhet të dorëzohet në origjinal ose kopje

Evidenca 11: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi:

- Listën e punëtorëve të përhershëm të kompanisë tuaj me të dhënat në vijim: Emri, mbiemrin, moshën e punëtorit, profesionin, eksperiencën (vite) dhe pozicionin në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, të nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik
- Kopja e diplomave të noterizuar nga origjinali (Kopja e diplomës duhet të dorëzohet e noterizuar në origjinal nga noteri), CV-it,
- kopja e kontratave të punës ose para kontratës me emër të projektit në origjinal
- Të ofrohet Vendim me shkrim për caktimin e menaxherit të projektit – duhet të dorëzohet në origjinal, të nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar	Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse				
III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve	Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>

NENI IV: PROCEDURA

IV.1.1) Lloji i procedurës
<input checked="" type="checkbox"/> E hapur

<input type="checkbox"/> E kufizuar
<input type="checkbox"/> Konkurruese me negociata
<input type="checkbox"/> Kuotim i Çmimit
<p>IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)</p> <p>Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:</p>
<p>IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociata)</p> <p>Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar</p> <p style="text-align: right;">Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>Autoritetet kontraktuese do të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata</p> <p style="text-align: right;">Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p>
<p>IV.1.4) Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është :</p>

IV.2) KRITERET E DHËNIES

<input checked="" type="checkbox"/> Tenderi i përgjegjshme me Çmimin më të ulët

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

<p>IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>Nëse po,</p> <p>Njoftim paraprak: _____</p> <p>Publikime tjera (nëse aplikohen): _____</p>
<p>IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit</p> <p>Afati i fundit për marrjen e dosje se tenderit deri me date 03/10/2016 , ora 15:00h.</p> <p>Kërkesat për pjesëmarrje në një aktivitet të prokurimit që shpjen drejt dhënies së ndonjë kontrate publike ose kornize , mund të paraqiten në mënyrë elektronike,</p> <p>Dokumentet me pagës Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/></p> <p>Nëse po, çmimi _____</p> <p>Kushtet dhe metoda e pagesës: _____</p>
<p>IV.3.3) Afati i fundit për pranim të tenderëve</p> <p>Data 06.10.2016 Koha 13:00h Vendi Objekti i Ministrisë, numri i zyrës 139, Kazerma "Adem JASHARI" rr. Magjistrale Prishtinë- Mitrovica, Prishtinë RKS</p>

IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar:	<input type="checkbox"/> po	<input checked="" type="checkbox"/> jo
Nëse po, jep arsyetim _____		
IV.3.5) A është e nevojshme siguria e tenderit:	Po <input checked="" type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit 1,000.00 € me kohëzgjatje 90 dite prej datës se pranimi te ofertave		
IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:	ditë 60 apo 2 muaj	
IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:	Data 06.10.2016 Koha 13:30h Vendi Objekti i Ministrisë, numri i zyrës 139, Kazerma "Adem JASHARI" rr. Magjistrale Prishtinë- Mitrovice, Prishtinë RKS	

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe

Ne rast mos përputhje mes gjuhëve dominon gjuha Shqipe

Shto informacione tjera: [si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj NA